



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Prima - Primeni: Më 22-02-2010	
Nr./ organit Org. nr. 01	Numri/Broj 01-03/1529-
Shtojcë Prilog	Vlera Vrednost



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 17 paragrafi 1 pika e, nenit 40.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr 03/L-040 të Kuvendit të Republikës së Kosovës “Gazeta Zyrtare nr 28/08” dhe në bazë të nenit 22.2 të Statutit të Komunës o2. nr. 013/5165 të datës 18.11.2008, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më 12.07.2010 aprovon këtë:

V E N D I M

PËR BARTJEN E TË DREJTËS SË SHFRYTËZIMIT TË PASURISË SË PA LUAJTSHME (TOKËS) NË PRONËSI TË KOMUNËS SË VITISË, NË SHFRYTËZUESIN E RI SHKOLLA FILLORE “NAZMI PAJAZITI” NË RADIVOJCË PARALELJA E NDARË NË DEVAJË

Neni 1

Me këtë vendim, Kuvendi i Komunës së Vitisë lejon që të bëhet bartja administrative e të drejtës së shfrytëzimit afatgjatë të pasurisë së pa luajtshme (tokës), në pronësi të Komunës së Vitisë, në emër të shfrytëzuesit të ri –Shkolla fillore “Nazmi Pajaziti” në Radivojc- paralelja e ndarë në Devajë, e cila evidentohet në ngastrën kadastrale nr 98-2 në vendin e quajtur “Golesh” me sipërfaqe prej 4.000m², Zona Kadastrale Devajë.

Neni 2.

Bartja administrative e të drejtës së shfrytëzimit afatgjatë të pasurisë së pa luajtshme nga neni 1 i këtij vendimi bëhet pa kompensim, duke u bazuar në kërkesën e Drejtorisë për Arsime të Komunës së Vitisë, nr 05-07/1529 e datës 24.05.2010.

Neni 3.

Obligohet Drejtoria për Kadastër, pronë dhe Gjeodezi e Komunës së Vitisë që në regjistra kadastral të bëjë ndërrimin e palujtëshmërisë nga neni 1 i këtij vendimi në emër të shfrytëzuesit të ri- shkolla fillore “Nazmi Pajaziti” në Radivojc për paralelen e ndarë në Devajë.

Neni 4.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi e Komunës së Vitisë.

Neni 5.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

Vendimi u dërgohet:

1. Shkollës fillore – Radivojc
2. Drejtorisë për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi
3. Arkivit

KRYETARI I KUVENDIT
Skenderbe Hebibi

